



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1911, datë 30.04.2012

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) midis sipërmarrësve Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 30.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) midis sipërmarrësve Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. me nr. 8Prot., datë 13.3.2012, (nr. 475Prot. i AKEP, datë 13.3.2012) “*Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Altelecom sh.a.*”
- Shkresa e Alban Tirana me nr. 12Prot, datë 2.5.2011, drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP, “*Mbi publikimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Altelecom sh.a.*”;
- Shkresa e Alban Tirana me nr. 15Prot., datë 8.6.2011, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës “*Mbi aplikimin e çmimeve diskriminuese nga Altelecom sh.a.*”;
- Shkresa e Altelecom sh.a. me nr. 4948Prot., datë 1.11.2011, drejtuar Alban Tirana, “*Mbi plotësimin e dokumentacionit për nënshkrimin e marrëveshjes së re akses / interkoneksionit*”;
- Shkresa e Alban Tirana me nr. 27Prot., datë 10.11.2011, drejtuar Altelecom sh.a., “*Përgjigje për shkresën me nr. 4948Prot., datë 1.11.2011*”;
- Procesverbal i i seancës paraprake dëgjimore mes palëve Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Altelecom sh.a., mbajtur me datë 6.4.2012, ora 12:00, në ambientet e AKEP;
- Shkresë e Alban Tirana me nr. 11Prot., datë 10.4.2012, (685Prot., datë 10.4.2012) “*Kërkesë për hapjen e negociatave për firmosjen e MI*” dërguar Altelecom sh.a.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Alban Tirana., me shkresën nr. 8Prot., datë 13.3.2012 “*Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Altelecom sh.a.*” sqaron si më poshtë:

1. Alban Tirana, nuk ka arritur të rinovojë marrëveshjen e interkoneksionit me Albtelecom sh.a., për arsye se oferta referencë e interkoneksionit e OFNT Albtelecom është diskriminuese dhe aspak reale;
2. Me shkresën nr. 12Prot, datë 2.5.2011, drejtuar KD së AKEP, Alban Tirana ka kërkuar miratimin e kësaj oferte duke rishikuar cmimet përkatëse të interkoneksionit bazuar në studimin e tregut, mesataren e BE-së, dhe kompetencave që i jep ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
3. Me shkresën nr. 15Prot., datë 8.6.2011, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, Alban Tirana ka argumentuar mbi fakte reale mbi politikën diskriminuese të çmimeve që ndjek Albtelecom sh.a. se si i njëjti shërbim në treg shitet nga Albtelecom me çmime të ndryshme ndaj përdoruesve fundorë dhe faturohet ndryshe për Alban Tiranën;
4. Me shkresën nr. 4948Prot., datë 1.11.2011, Albtelecom sh.a. i është drejtuar Alban Tirana për plotësim dokumentacioni për nënshkrimin e marrëveshjes së re për akses dhe interkoneksion, bazuar në RIO-n e re. Gjithashtu, më datë 9.11.2011, me kërkesë të Albtelecom është zhvilluar takim mes palëve me qëllim gjetjen e mënyrave për rinovimin e marrëveshjes duke premtuar rishikimin e çmimeve të origjinimit. Pas këtij takimi nuk ka asnjë përgjigje, megjithëse është dërguar edhe shkresa me nr. 27Prot., datë 10.11.2011;
5. Alban Tirana, argumenton pse çmimi i origjinimit në ORI të Albtelecom prej 3.5 lekë/min, plus 0.83 lekë/thirrje, është jo real, shumë i ekzagjeruar dhe diskriminues. Prej datës 1 shtator 2010, Albtelecom tarifon për akses 3.5 lekë/min (pa TVSH) plus 0.83 lekë/thirrje, ndërkohë të klientët fundorë e shet me çmim shumë më të ulët. Si shembull Alban Tirana, sjell ofertën e Albtelecom, “Fol Fix 1500, fol pa kursyer”, në të cilën ofron 1500 minuta brenda rrjetit Albtelecom, 30 minuta me operatorët celularë kombëtarë, 30 minuta me operatorët fiks në Europë dhe fiks dhe celularë në Amerikë dhe Kanada, si dhe pajtimin mujor dhe TVSH për 1500 lekë.
6. Alban Tirana, me anë të shkresave i ka kujtuar Albtelecom sh.a. se si OFNT është i detyruar të shesë me çmime të orientuara drejt kostos. Dhe sa më sipër del qartë se kosto e minutës për Albtelecom është shumë më e ulët se ajo që i shet Alban Tiranës. (*Çmimi që Albtelecom e shet këtë shërbim është më pak se 1 lekë/min apo Albtelecom po e shet këtë shërbim nën kosto?*);
7. Alban Tirana, sqaron se çmimi i lartë i dhënë nga Albtelecom, sjell dëme të pariparueshme, jo vetëm për shoqërinë por edhe për konsumatorët që e paguajnë atë. Kjo sjellje me dy standarde e Albtelecom, çon në deformim të tregut dhe me kalimin e kohës në se nuk ka ndërhyrje nga organet kompetente, do të çojë në falimentimin e pashmangshëm të kompanisë.
8. Në përfundim Alban Tirana, i kërkon AKEP që bazuar në nenin 120, të ligjit nr. 9918 dhe ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative”, të fillojë procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Alban Tirana dhe Albtelecom sh.a.

9. AKEP, më datë 6.4.2012, ora 12:00, zhvilloi një seancë paraprake me palët në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së Alban Tiranës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për akses/interkoneksion për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP). Palët në këtë takim mbajtën të njëjtin qëndrim, të parashtruar më parë në pretendimet e tyre. Në fund të takimit nga AKEP, palëve iu la afat brenda një jave të na sjellin përgjigje në lidhje me vijimin e negociatave. Brenda këtij afati, nga Alban Tirana depozitohet shkresa me nr. 11Prot, datë 10.4.2012, “Kërkesë për hapjen e negociatave për firmosjen e MP” dërguar Altelecom sh.a. Nga Altelecom sh.a. nuk ka depozituar shkresë.

II. Duke qenë se, sipërmarrësit Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Altelecom sh.a. megjithë përpjekjet e bëra edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për nënshkrimin e marrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) midis tyre, AKEP, në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së akses/interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë (OSHKP) midis Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:

- Altin Rrapaj Kryetar
- Jonida Gjika Anëtar
- Nuredin Hasanaj Anëtar
- Esmeralda Dervishi Anëtar
- Dritan Malaj Anëtar

3. Të njoftohen palët e interesuara Alban-Tirana Nascendo Al sh.p.k. dhe Altelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;

4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE